

Sipas dispozitave të Rregullores së UNMIK-ut me Nr.2001/35, mbi pensionet në Kosovë, të datës 22 Dhjetor 2001,

Me qëllim të ekzekutimit të Nenit 24 të Rregullores së UNMIK-ut me Nr. 2001/35 (Rregullorja e Pensionit), në parashkrimin e rregullës dhe procedurave në shuarjen e Pensioneve Suplementare Individuale,

Bordi i Drejtorëve të Autoritetit Bankar të Pagesave të Kosovës (BPK), në mbledhjen e tij të mbajtur më 23 tetor 2002 miraton si vijon:

## **Rregulla 22 mbi shuarjen e Pensioneve Individuale Suplementare**

### **Neni 1 Sfera dhe qëllimi i Rregullës**

#### **1.1 Sfera e Rregullës**

Kjo rregull i adresohet Siguruesit të Pensionit që ofron dhe mban programin e Pensionit Individual Suplementar, trupat e tyre drejtues dhe, aty ku aplikohet, Menagjeri Special i emruar nga BPK-ja në pajtueshmëri me këtë Rregull.

#### **1.2 Qëllimi i Rregullës**

Kjo Rregull parashkruan udhizimet dhe kërkesat që duhet të plotsohen për shuarjen e Pensionit Individual Suplementar. Kjo poashtu parashkruan disa detyra të caktuara të Siguruesit të Pensionit (Sponsorit), bordit drejtues të tij, dhe, aty ku aplikohet, Menagjeri Special i emruar nga BPK-ja që të zhvilloj likuidimin dhe distribuimin e mjeteve të pensionit. Kjo rregull mundohet të sigurojë mbrojtjen optimale të pjesmarrësit në rastë se programi i Pensionit Individual Suplementar shuhet.

### **Neni 2 Dispozitat e përgjithshme**

#### **2.1 Definimi**

Të gjitha termet e shfrytzuara në këtë Rregull janë ashtu siq janë definuar në Rregulloren e Pensionit dhe/ose siq definojnë më pas në këtë Rregull.

“Veprimet e zbatimit”, në këtë Rregull, nënkuptojnë urdhërin ose direktivën e BPK-s në lidhje me pezullimin ose anulimin e licensës së Siguruesit të Pensionit në lidhshmëri me biznesin e tij të programit(ve) suplementar Individual sponsorues të Pensionit.

“Shuarja jovullnetare” i referohet shuarjes së programit të Pensionit Individual Suplementar ose licensa e Siguruesit të Pensionit si e tillë, nëpërmes të veprimeve

zbatuese të BPK-s në pajtueshmëri me dispozitat e Rregullores së Pensionit dhe kësaj Rregulle.

“Menagjeri Special” nënkupton individin ose personin e emëruar nga BPK-ja që të administroj dhe menagjoj programin e Pensionit dhe mjetet e tij, gjatë likuidimit. Termi përfshinë administratorin, pranuesin, ruajtsin ose likuidatorin që do të emrohet nga BPK-ja (ose trupin rregullator që do të mirret me funksionet rregullatore dhe mbikqyrse të bankave dhe/ose kompanive të sigurimit) në pajtim me rregulloret dhe ligjet e aplikueshme bankare dhe të sigurimit.

“Shuarja me veprimin e ligjit” i referohet kushtit ku programi i Pensionit Suplementar Individual është shuar për shkak të likuidimit ose bankrotimit të Siguruesit të Pensionit sponsorues.

“Shuarja vullnetare” i referohet shuarjes së programit të Pensionit Suplementar Individual që është inicuar me njohtim me shkrim të bërë nga trupi drejtues i Siguruesit të Pensionit për pjesmarrësit dhe BPK-n.

## **2.2 Faktori rregullator në shuarjen e Fondit të Pensionit**

Rregullorja e Pensionit dhe këto Rregulla e ndihmojnë rritjen dhe zgjerimin e pensioneve dhe mjeteve të tyre dhe sigurojnë se veprimet zbatuese në drejtim të shuarjes së programit të Pensionit janë ndërmarrë vetëm kur janë të nevojshme që të mbrojnë interesin e pjesmarrësit. Siguruesit e rregullimit Pensional Individual Suplementar janë bankat, institucionet financiare dhe kompanitë e sigurimit. Rregulloret dhe ligjet e aplikueshme bankare dhe të sigurimit primarisht rregullojnë zhvillimin e biznesit të këtyre entiteteve. Mirpo, në rast se programi(et) i Pensionit Individual Suplementar që këto entitete i sponsorojnë, është shumë e nevojshme që të përcaktohet që qdo shuarje e programeve të tilla të Pensioneve të ket parashysh kërkesat si vijojnë:

- a) Në rastë të shuarjes vullnetare, trupat drejtues të Siguruesit të Pensionit duhet të kënaqin BPK-n se shuarja është e nevojshme në mënyrë që të mbrojë dhe ruaj interesat e pjesmarrësve dhe mjeteve të pensionit.
- b) Në rastë të shuarjes me veprimin e ligjit, bordi drejtues i Siguruesit të Pensionit duhet të jetë pajtuar me obligimet e tyre fiduciare për njohtim me kohë, pjesmarrësit rreth likuidimit dhe bankrotimit të Siguruesit të Pensionit me deklaratën rreth kushteve të mjeteve të pensioneve që janë shpërndarë për benefitin e vetëm të pjesmarrësve dhe/ose përfituesve.
- c) Në rastë të shuarjes jovullnetare, BPK-ja duhet të zbatoj kërkesat e njohtimit të arsyeshëm paraprak, për derisa interesi i pjesmarrësve është një rrezik imediat, në mënyrë që ti mundsojë bordit drejtues të Siguruesit të Pensionit:

1. Kohë të arsyeshme që ti sanojë devijimet, thyerjet ose shkeljet që përbëjnë bazat për veprimet e zbatuara.
2. Njohtim të duhur për veprimet e zbatuara.
3. Të përshtat mënyrën dhe mjetet për të mbrojtur interesat e pjesmarrësve dhe përfituesve të pensionit.
4. Shërbimet profesionale të Menagjerit special, nëse është e nevojshme, që të administroj dhe menagjoj programin e Pensionit dhe mjetet e tij në likuidim, në mënyrë që:
  - (i) Të sigurojë një likuidim më të lehtë dhe distribuim të mjeteve të pensionit për pjesmarrësit dhe përfituesit.
  - (ii) Të sigurojë se distribuimi i mjeteve të pensionit të pjesmarrësve është transferuar si duhet në rregullimin tjetër personal, nëse titullimi i pensionit nuk është ende në rend.

### **Neni 3**

#### **Shuarja e Pensionit Suplementar Individual**

##### **3.1 Anulimi i licensës së siguruesit të pensionit**

Shuarja e programit të Pensionit Suplementar Individual është paraprirë nga veprimet e mëhershme të zbatuara, duke përfshirë anulimin e licensës së Siguruesit të Pensionit. BPK-ja duhet të anuloj licensën në rrethana si vijojnë:

- a) Dorzimi vullnetar i licensës. Në dorzimin vullnetar të licensës së Siguruesit të pensionit, duhet të përmbushen kërkesat si vijojnë:
  1. Bordi i drejtorëve të Siguruesit të Pensionit mundet, në qdo kohë, me shkrim, të kërkojë prej BPK-s për shuarjen e programit të tij të pensionit Suplementar Individual, duke specifikuar arsyet për këtë.
  2. Njohtimi me shkrim për këtë shuarje vullnetare i është dhënë të gjithë pjesmarrësve dhe BPK-s, 90 ditë para datës së caktuar të shuarjes.
  3. Menjëherë me dërgimin e këtij njohtimi, bordi i drejtorëve duhet të pregadis vlersimin e mjeteve të pensionit dhe të ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për të mbrojtur interesin e pjesmarrësve dhe përfituesve.
  4. Shuarja e programit të Pensionit Suplementar Individual duhet të zhvillohet sipas rregullores dhe rregullave të aplikueshme bankare dhe të sigurimit, duke siguruar se likuidimi i mjeteve të pensionit do të jetë nën

mbikqyrjen e Departamentit të Pensioneve të BPK-s në pajtueshmëri me këto Rregulla.

5. Në lirinë e tij të veprimit, në menyrë që të mundsojë mjetet më të mirë të mundshme të mbrojtjes së interesit të pjesëmarrësve dhe përfituesve, BPK mund të lëshoj një urdhër për të ngrirë mjetet e programit të Pensionit Individual Suplementar; ose anuloj licensën, ose të dyja, dhe të caktoj menagjerin special që të menagjoj mjetet e pensionit në pajtim me procedurat e përshkruara në nenin 4 të Rregullës 21, të këtyre Rregullave.
- b) Me veprimin e ligjit. Licenca e Siguruesit të Pensionit është anuluar nga BPK-ja pa nevojë të njohtimit paraprak, urdhërit ose direktivat ku Siguruesi i Pensionit është likuiduar ose deklaruar i bankrotuar. Në këtë situatë BPK-ja duhet që:
1. Menjëherë të lëshojë një urdhër për të ngrirë mjetet e pensionit dhe të anuloj licensën e Siguruesit të Pensionit dhe
  2. Koordinojë me Rregullatorin Bankar dhe/ose të Sigurimit në mënyrë që të sigurojë se likuidimi dhe distribuimi i mjeteve të pensionit është ndërmarrë nën mbikqyrjen e Departamentit të Pensioneve të BPK-s.
  3. Në lirinë e tij të veprimit, të caktoj menagjerin special në pajtim me këtë Paragraf të Rregullës 21, të këtyre Rregullave.
- c) Anulimi jovullnetar. BPK-ja ndërmerr veprime specifike që të anuloj licensën e Siguruesit të Pensionit duke u bazuar në kriteret e specifikuar në Rregulloren e Pensionit dhe Rregullën 2 të këtyre Rregullave. Anulimi i licensës së Siguruesit të Pensionit kërkon kushtet si vijojnë:
1. Njohtimi. Në rastet kur BPK anulon licensën e Siguruesit të Pensionit:
    - (i) Njohtimi me shkrim jo më herët se 30 ditë të datës së caktuar të anulimit duhet të dërgohet te bordi i drejtorëve i Siguruesit të Pensionit.
    - (ii) Njohtimi duhet qartë të tregojë arsyen ose arsyet që përbëjnë bazën për anulim.
    - (iii) Njohtimi duhet që bordit të drejtorëve të ju jep kohë jo më shkurtë se 30 ditë për të paraqitur shkakun që urdhëri i anulimit të mos lëshohet.
    - (iv) Brenda periodës prej 30 ditësh prej lëshimit të njohtimit të anulimit, bordi i drejtorëve të Siguruesit të Pensionit

parashtron planin e shkruar të përshtatshmërisë për të larguar bazat në të cilat është bazuar urdhëri për anulim.

- (v) Nëse BPK-ja është e kënaqur me planin e përshtatshmërisë, urdhëri për anulim, nëse një veq është lëshuar, është hjekur dhe licenca është restauruar varsisht prej restriksioneve të caktuara, limitimeve ose kushteve që BPK mundë të ngarkoj.
- (vi) Nëse bordi i drejtorëve dështon që të parashtrorj planin e përshtatshmërisë brenda numrit të specifikuar të ditëve, ose nëse BPK nuk është e kënaqur me planin e përshtatshmërisë të parashtruar nga bordi i drejtorëve, BPK-ja mundë të vazhdojë të anuloj licensën e Siguruesit të Pensionit dhe të lëshojë veprime tjera të zbatuara dhe urdhëri për shuarjen e programit të Pensionit Individual Suplementar të Siguruesit të Pensionit në pajtim me këtë Rregull.

### **3.2 Veprimet e zbatuara**

Me anulimin e licensës së Siguruesit të Pensionit, BPK-ja duhet të ndërmarrr veprimet zbatuese si vijon:

- a) Të lëshojë dhe dërgojë “Urdhërin për ngrirje” për mjetet e pensionit (ose të bëjë “urdhërin për ngrirje” të mëhershëm, permanent. Te Kujdestari dhe Menagjeri(et) i mjeteve duke përfshirë kopjen e urdhërit për anulim.
- b) Të lëshojë një urdhër te bordi drejtues i Siguruesit të Pensionit që të ndërprejë dhe pushojë pranimin e kontributeve të pensionit dhe kontraktimin ose pagesën e titullimeve të reja.
- c) Të urdhëroj shuarjen e programit(ve) të Pensionit Individual Suplementar dhe likuidimin dhe distribuimin e mjeteve të pensioneve në pajtim me Nenin 4 të kësaj Rregulle.
- d) Në lirinë e veprimit, të emroj menagjerin special të kualifikuar që të menagjoj mjetet e pensionit që të arrit distribuimin më të favorshëm të mjeteve për pjesmarrësit dhe përfituesit.
- e) Si është garantuar, urdhëron trupin drejtues të Siguruesit të Pensionit që të transmetoj te menagjeri special (ose në BPK) të gjitha shënimet dhe dokumentet që i takojnë programit të pensioneve dhe mjeteve brenda afatit kohor dhe duke zbatuar procedurat e aplikueshme të rregulluar më herët në Rregullat e Pensionit për derisa BPK-ja, në interesin e pjesmarrësve dhe përfituesve, urdhëron një kohë më të herëshme ose mënyrë të ndryshme që të bëjnë një transmetim të tillë.

## **Neni 4**

### **Shuarja e Fondit të Pensionit**

#### **4.1 Menagjeri Special**

Në lirinë e saj të veprimit, BPK-ja mundë të emroj menagjerin special që të administroj dhe menagjoj mjetet e pensionit që i takojnë programit(ve) të Pensionit Individual Suplementar. Kualifikimi, detyrat dhe përgjegjësitë e menagjerit special do të jetë në pajtueshmëri me Nenin 4, Rregulla 21, e kësaj Rregulle.

#### **4.2 Shuarja (likuidimi) e programit të Pensionit Suplementar Individual**

Procedurat dhe kërkesat për shuarjen e programit të Pensioneve Individuale Suplementare duhet të sigurojë mbrojtjen më të mirë të mundshme të interesit të pjesmarrësve dhe përfituesve. Një shuarje e tillë duhet të zhvillohet në pajtim me udhizimet si vijojnë:

- a) Shuarja nga Menagjeri Special (administratori, pranuesi, ruajtësi, likuidatori etj.)
  1. Procedurat, kushtet, termet dhe kërkesat e parashkuara në Nenin 4, Rregulla 21 e këtyre Rregullave të aplikueshme për shuarjen e pensioneve nga Menagjeri Special për likuidim dhe distribuim të mjeteve të pensionit, duhen të zbatohen.
- b) Shuarja nga Bordi i Drejtorëve të Siguruesit të pensionit
  2. Si rregull e përgjithshme, shuarja e programit të Pensionit Individual Suplementar duhet të ndërmerret sipas ligjeve dhe procedurave të aplikueshme në rregulloret dhe ligjet bankare dhe/ose të sigurimit. Dispozitat e aplikueshme në Rregullën e Pensionit duhet të zbatohen.
  3. Të gjitha shuarjet e programit të Pensionit Individual Suplementar, likuidimi dhe distribuimi i mjeteve të pensionit, do të jetë nën mbikqyrjen e Departamentit të Pensioneve në BPK.
  4. Udhëheqsi i Departamentit të Mbikqyrjes së Pensioneve në BPK duhet të koordinojë me udhheqsit e Mbikqyrjes Bankare dhe/ose Departamentit të Mbikqyrjes së Sigurimit ( ose trupi i duhur rregullator që në fundë do të ngarkohet me rolin mbikqyrës mbi bankat dhe kompanitë e sigurimit), të sigurojë se likuidimi dhe distribuimi i mjeteve të pensionit përputhet në mënyrë qensore me termet, kushtet dhe kërkesat e parashkuara në nën-nenin 4 c) të Rregullës 21, të këtyre Rregullave.

## **Neni 5**

### **Të drejtat e pjesmarrësve në shuarjen e Pensioneve Individuale Suplementare**

#### **5.1 Të drejtat e Pjesmarrësve dhe Përfituesve që të paraqesin ankesat**

Pjesmarrësit e programit Individual Suplementar që është shuar kanë të drejtë të paraqesin kërkesat ndaj Siguruesit të Pensionit, bordit të tij të drejtorëve, menagjerit të mjeteve dhe kujdestarit dhe/ose menagjerit special, ose ndonjë fiduciari, ose pale të bashkuar të këtyre entiteteve ndaj të cilëve ai/ajo ose ata mundë të themelojnë arsyen ose arsyet e vperimeve. Për ta zbatuar këtë të drejtë pjesmarrësi ose pjesmarrësit mund të vazhdojnë me veprimet si vijojnë:

- a) Pjesmarrsi(et) prezenton kërkesën e asaj/atij në BPK për zgjidhje me fiduciarët e cituara të programit të Pensionit dhe mjeteve të tij.
- b) Pjesmarrsi(et) ndërmer një veprim në gjyq ( si p.sh. shkelja e detyrave fiduciare) ndaj ndonjerit ose të gjithë fiduciarve të mjeteve të pensionit.

### **Neni 6 Hyrja në fuqi**

Kjo Rregull duhet të hyj në fuqi më 23 tetor 2002.

---

Drejtori i Përgjithshëm